Republika e Kosovës

Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM

(ME NJË OPERATOR EKONOMIK)

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson U.D. i Menaxheri-ja e Prokurimit z. Zizë Bujupaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositësit te furnizimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë; dhe

"BENI DONA PLAST" Shpk, të cilën e përfaqëson Drejtori, z. Ragip Mustafa , nga Istogu, me Nr. Rexhistrimit te biznesit: 810545981, ne vazhdim "FURNITORI", në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për FURNIZIMET si më poshtë:

FURNIZIMI ME PAKO USHQIMORE PËR FAMILJE SKAMNORE

Nr. I prokurimit	**633 - 20 - 7115-1-2-1/FA070**
Nr. I brendshëm	**633 / 020/ 121 / 121**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzmin e mallrave si në vijim:

FURNIZIMI ME PAKO USHQIMORE PËR FAMILJET SKAMNORE

Autoriteti Kontraktues bënë Furnizimin vetëm në emër të vetë Autoritetit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative që Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është i detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të kryejnë furnizime të përmendura në 1.1.ë

1.4 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË PËRKATËSISHT ME DATË **15.12.2020** DHE DO TE PERFUNDOJË ME SË LARTI DERI ME **15.12.2021**

1.5 Kontrata mund të shkëputet edhe para skadimit te afatit te paraparë në Nenin 1.4. te kësajë kontrate, po qe se e njëjta permbushet me çmimin e paraparë sipas dispozitave te Nenit 56.10 te Udhezuesit Operativ ku "citohet" se nese

kontrata permbushet me çmim pa marre parasysh Kohën e zgjatjes dhe nenshkrimin original e njëjta shkeputet automatikisht.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjën e të gjitha **FURNIZIMEVE** do të jetë: **15.12. 2021** si afat I skadimit te afatit te kontratës.

2.2 Vendi ku do te dorëzohen artikujt do të jenë **Familjet skamnore te Komunës së Istogut e percaktuara, bazuar ne listën paraprake, respektivisht do te caktohet nga Drejtorati për Shërbime Publike.**

2.3. Obligimet e kontrakorit janë te gjitha furnizimet të percaktuara ne Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve te pergjithshme dhe te veqanta te kontratës.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP[1] (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Kryersi I furnizimeve duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të tyre. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi:

4.1 Kjo kontratë është e lidhur me çmime për njësi. Çmimet njësi. të furnizimeve janë të paraqitura ne ofertën financiare te kontraktorit datë **13.11.2020** dhe kjo shumë është **20,36 €** dhe me shkronja: **/Njëzetpresjetridhjetegjashtë/**

Vlera totale e kontratës është **34.695,00** ë: **Euro. Dhe me shkronja: /Tridhjetëekatërmijëegjashtëçindenëntëdhjetëepesëzerozeroeuro/, Devijim i lejuar + - 30% LPP-së**

4.2 Çmimi i përmendur për NJËSI në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do t'i nënshtrohen ndryshimeve për porosity e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

(a) Kontrata Publike Kornizë;

(b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

(e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

(f) Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontrates

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut:

Për Furnizuesin:
"Beni Dona Plast" Shpk

Emri:	***Gëzim Ademaj***	***Emri:***	***Ragip Mustafa***
Pozita:	***U.D.*** ***I Menaxher-it Prokurimit***	***Pozita:***	***D r e j t o r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	15. 12. 2020	***Data:***	15.12.2020
Vula:		***Vula:***	

PJESA III E KONTRATES: kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të filloj menjehere
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë pas 12muajsh,.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

	KOMUAN ISTOG		Çmimi per njesi		
	PARAMASA PËR GJËRA USHQIMORE DHE HIGJIENIKE(REZERVA)		PËR RASTE TE COVID/19, KATEGORI SOCIALE, QERD		
Nr	**Pershkrimi**	**Njësia**	**Sasia e perafert**	**Sasia**	**Çmimi per njesi**
	Emri i Artikullit(Përshkrimi) pako ushqimore				
1	Miell (tip 400) 25 kg/1	Thasë	**1500**	**1**	7.50
2	Vaj ushqimor 1/1	lit	**3500**	**1**	1.25
3	Qumshtë i pa sterilzuar 3.2 (tetrapakë)1/1	lit	**3500**	**1**	0.88
4	Sheqer 4/1	kg	**3000**	**1**	0.79
5	Oriz 1/1	kg	**1400**	**1**	1.25
6	Pasta makarona divella (apo të barazvlefshme) 1/2 kg	kg	**3000**	**1**	0.59
7	Pasul 1/800 gr	copë	**1400**	**1**	2.00
8	Krip e jodizur 1/1	kg	**1400**	**1**	0.15
9	Konzerva argeta 1/0.95 g (apo e barazvlefshme)	copë	**4400**	**1**	0.65
	Emri i artikullit(pershkrimi) pako higjienike				
1	Detegjent për rroba 3/1 kg (pluhur)	copë	**2200**	**1**	0.70
2	Shampon për enë 1/1	lit	**700**	**1**	0.40
3	Shampon për duar 1/1	lit	**700**	**1**	0.70
4	Shampon për flokë 1/0.350 l	copë	**700**	**1**	0.40
5	Sapun i ngurt (40 gr.) per larje te trupit	copë	**1400**	**1**	0.20
6	Pastë për dhembë 1/75 ml	copë	**1400**	**1**	0.50
7	Dezinfektues per toaletë (domesdos apo l barazvlefshem) 1/0.75 l	copë	**700**	**1**	0.65
8	Doreza njëperdorimeshe 1/100 (doreza LATEX, njeperdorimeshe, pa puder, madhesia S,M,L dhe XL	copë	**100**	**1**	0.50
9	Leter toaleti ne rollne: Leter cilesore, e but me dy shtresa, ngjyrë e bardhë. Njësia/paketimi 10/1	copë	**150**	**1**	0.60
10	Letr për duar, z-palosje e bardhë. Një fije - leter të cilesisë së fortë. Rreth 220-250 flet për paketë (20cmx10cm)	copë	**100**	**1**	0.65
	TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT I CMIMEVE PER NJESI				20.36
	Liferimi i pakove ushqimore duhet te behet nga operatori ekonomik gjere tek familjet skamnore, varsisht nga kerkesat e njesise kerkuese. (Brenda komunes se Istogut)				

Enver Rugova_____